

Scaris Pleura



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i posaçëm parlamentar "Për hartimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 15, datë 05.03.2015 "Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian""

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2023

Lënda: Nismë ligjore për amendimin e ligjit nr. 15/2015 "Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian"

Drejtuar: Znj. Lindita Nikolla
Kryetare e Kuvendit

E nderuar Kryetare,

Bazuar në nenet 77, 81, pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 24 të Rregullores të Kuvendit, ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim në Kuvend projektligjin Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2015 "Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian"

Bashkëlidhur gjeni raportin dhe tekstin e projektligjit

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

Taulant BALLA

BASHKËKRYETAR

Jorida TABAKU

BASHKËKRYETARE



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 15/2015
“PËR ROLIN E KUVENDIT NË PROCESIN E INTEGRIMIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN”**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozim të deputetëve,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European” bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 2 riformulohet me këtë përmbajtje:

“Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për marrëdhëniet e Kuvendit me Këshillin e Ministrave, ministrin përgjegjës për negociatat, institucionet e pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European.”.

Neni 2

Në nenin 3 pas shkronjës “b” shtohen shkronjat “b/1”, “b/2” dhe “b/3” me këtë përmbajtje:

“b/1. dhënie e rekomandimeve për pozicionet negociuese të Republikës së Shqipërisë në negociatat e anëtarësimit në Bashkimin European;

b/2. monitorimin e kriterëve të vendosura gjatë procesit të negociatave;

b/3. informimin mbi gjetjet kryesore të raportit të shqyrtimit analitik të legjislacionit të Komisionit European.”.

Neni 3

Në nenin 4 shkronja “ë” riformulohet:

ë) “Legjislacioni i Bashkimit European” është korpusi i normave të detyrueshme dhe të rekomandueshme në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit European”.

Në nenin 4 pas shkronjës “g” shtohet shkronjat “gj” me këtë përmbajtje:

gj) “pozicion negociues” është pozicioni që do të prezantojë Republika e Shqipërisë për kapituj ose grup kapitujsh.”.

Neni 4

1. Neni 6, pika 3, riformulohet sime poshtë:

“3 Këshilli Kombëtar i Integritetit European përbëhet nga:

- a) kryetarët dhe nënkryetarët e komisioneve të përhershme parlamentare;
- b) përfaqësues të grupeve parlamentare të Kuvendit;
- c) kryesuesi i delegacionit shqiptar në Komitetin Parlamentar për Stabilizim- Asociimin;
- ç) Avokati i Popullit;
- d) ministri përgjegjës për integritetin dhe ministëri përgjegjës për negociatat me Bashkimin European;
- dh) përfaqësues nga kabineti i Kryeministrit;
- e) përfaqësues nga Ministria e Jashtme;
- ë) përfaqësues nga Kabineti i Presidentit;
- f) Prokurori i Përgjithshëm;
- g) Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
- gj) përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile të përfshirë në çështje të integritetit european, të cilët i përgjigjen thirrjes për aplikim dhe ftohen për çdo grup-kapitujsh.

2. Neni 6, pika 4, riformulohet si më poshtë:

“4. Në takimet e Këshillit Kombëtar të Integritetit European marrin pjesë me statusin e të ftuarit sipas tematikës të takimit:

- a) titullarët e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, që raportojnë dhe informojnë Kuvendin;
- b) përfaqësues nga organizatat e biznesit, dhomat e tregtisë, sindikatat, të cilët i përgjigjen thirrjes për aplikim në bazë të fushës së përgjegjësisë;
- ç) përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe institucionet e arsimit të lartë publik;
- d) përfaqësues nga media, të cilët i përgjigjen thirrjes për aplikim;
- dh) përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe të trupit diplomatik.

Neni 5

Neni 7 riformulohet si më poshtë:

“1. Këshilli Kombëtar i Integritetit ka këto përgjegjësi:

- a) nxit bashkëpunimin midis forcave politike, institucioneve shtetërore dhe të pavarura dhe shoqërisë civile në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian;
 - b) siguron diskutim të vazhdueshëm për politikën e integritit europian, të zbatuara nga institucionet shtetërore me shoqërinë civile dhe me aktorë të tjerë të interesuar;
 - c) monitoron zbatimin e detyrimeve gjatë procesit të negociatave të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe jep rekomandimet përkatëse për çështjet e shqyrtuara tek institucionet përgjegjëse, si dhe informon sipas rastit Komisionin për Çështjet Europiane për gjetjet e konstatuara gjatë monitorimit;
 - ç) organizon takime me grupet e interesit dhe përfaqësues të shoqërisë civile lidhur me çështje që lidhen me detyrimet për hapjen dhe mbylljen e kapitujve të negociatave;
 - d) zhvillon takime me ministrin përgjegjës për negociatat dhe me strukturën përgjegjëse për negociatat;
 - dh) këshillon dhe jep opinione në lidhje me ecurinë e procesit të negociatave;
 - e) mban kontakte dhe shkëmben informacion me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin nëpërmjet kryetarit të Këshillit Kombëtar për Integritim Europian;
 - ë) raporton një herë në vit në Kuvend për punën e Këshillit.
2. Gjatë veprimtarisë së tij Këshilli shqyrton dhe këshillon për çështje që vlerësohen të rëndësishme për procesin e integritit europian.”.

Neni 6

Neni 8 riformulohet si më poshtë:

- “1. Këshilli Kombëtar i Integritit Europian asistohet nga Sekretariati Teknik, i cili kryen funksione këshillimore dhe administrative dhe përbëhet nga punonjësit e administratës së Kuvendit.
- 2. Rregullat e detajuara për përbërjen, organizimin, funksionimin, numrin e punonjësve dhe përgjegjësitë e Sekretariatit Teknik miratohen me vendim të Byrosë së Kuvendit.
- 3. Vendimi i Byrosë së Kuvendit për shtim të numrit të punonjësve në organikën e Kuvendit i dërgohet Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Financave për sigurimin e mbështetjes së nevojshme buxhetore për këtë qëllim.”.

Neni 7

- 1. Titulli i nenit 10 ndryshohet dhe bëhet “Komisioni për Çështjet Europiane” dhe riformulohet si më poshtë:

“Neni 10

Komisioni për Çështjet Europiane

Komisioni për Çështjet Europiane është organ i përhershëm i Kuvendit, që ka në fushën e përgjegjësisë së tij:

- a) çështjet e integritit europian;
- b) përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian;

c) monitorimin e zbatimit të kriterëve gjatë procesit të negociatave, angazhimeve që rrjedhin nga kuadri negociator, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, si dhe të asistencës financiare të Bashkimit European për Shqipërinë;

ç) shqyrtimin dhe dhënien e rekomandimeve për pozicionet negociuese të Shqipërisë.”

Neni 8

Neni 11 riformulohet si më poshtë:

“1. Kuvendi, në ushtrim të funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore, në lidhje me çështjet europiane:

a) siguron përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit European në ushtrimin e funksionit legjislativ;

b) monitoron dhe kontrollon punën e Këshillit të Ministrave, ministrit përgjegjës për negociatat, institucioneve të ngarkuara për zbatimin e detyrave në procesin e anëtarësimit në Bashkimin European;

c) shqyrton raportet/konkluzionet e Bashkimit European dhe qëndrimet e Republikës së Shqipërisë dhe jep rekomandime mbi to;

ç) bashkëpunon me Parlamentin European dhe me parlamentet e vendeve anëtare të Bashkimit European;

d) monitoron punën e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj për çështjet e integritetit european dhe bashkëpunon me to;

dh) bashkëpunon me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për çështjet e integritetit european;

e) përfaqëson interesat e qytetarëve në procesin e negociatave, në takime dhe në forumet e përbashkëta me institucionet europiane;

ë) informon publikun për pozicionin e institucioneve europiane dhe vendeve anëtare të Bashkimit European ndaj procesit të negociatave të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European.

2. Kuvendi në lidhje me çështjet europiane angazhohet edhe për:

a) vendosjen e dialogut të përshtatshëm politik ndërmjet palëve në proces;

b) monitorimin e zbatimit të kuadrit negociator, Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe asistencën financiare të Bashkimit European;

c) forcimin e bashkëpunimit rajonal për çështjet e integritetit european.”.

Neni 9

Në nenin 14 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli i nenit 14 ndryshohet dhe bëhet “Kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit për Çështjet Europiane”.

2. Në fjalinë hyrëse termi “Komisioni për Integrimin European” zëvendësohet me termin “Komisioni për Çështjet Europiane”.

3. Pas shkronjës “ë” shtohen shkronjat “f”, “g”, “gj”, “h”, “i”, “j”, “k”, “l” me këtë përmbajtje:

f) shqyrton pozicionet negociuese të paraqitura nga struktura negociatore dhe harton një raport të posaçëm me rekomandime lidhur me këto pozicione negociuese;

g) lehtëson debatin politik dhe gjetjen e konsensusit ndërpartiak për miratimin dhe ndryshimin e ligjeve, strategjive apo rezolutave të nevojshme për përsheptimin e procesit të negociatave;

gj) kërkon raportime periodike çdo 3 muaj nga ministri përgjegjës për negociatat për ecurinë e procesit të negociatave;

h) në bashkërendim me Komisionin për Politikën e Jashtme organizon takime dhe diskutime me parlamentet kombëtare të shteteve anëtare dhe Parlamentin Europian;

i) thërret sipas nevojës ekspertë të fushave përkatëse dhe grupe interesi për mendim;

j) mbikëqyr zbatimin e kriterëve gjatë procesit të negociatave;

k) shqyrton të gjitha marrëveshjet që lidhen me institucionet e Bashkimit Europian dhe/ose me vendet e Bashkimit Europian, si dhe marrëveshjet me karakter të mbështetjes financiare;

l) zhvillon mbledhje të përbashkëta me komisionet e tjera parlamentare për çdo projektakt që mbart ndikim në procesin e anëtarësimit.”

Neni 10

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 14/1

Procedura për shqyrtimin e pozicioneve negociuese

1. Ministri përgjegjës për negociatat i paraqet Komisionit për Çështjet Europiane pozicionin negociues.

2. Komisioni për Çështjet Europiane e përfshin pozicionin negociues në kalendarin e punimeve të tij dhe e shqyrton jo më vonë se 14 ditë nga data e paraqitjes së pozicionit negociues ose brenda një afati më të ngushtë në përputhje me kalendarin e takimeve negociuese me Bashkimin Europian.

3. Në rast se pozicioni negociues nuk është përfshirë në kalendarin e punimeve të Komisionit brenda 4 ditëve nga data e paraqitjes të tij, ai automatikisht konsiderohet i përfshirë në kalendar, i cili e shqyrton atë jo më vonë se 10 ditë nga data e përfshirjes në kalendar.

4. Komisioni për Çështjet Europiane në përfundim të shqyrtimit të pozicionit negociues miraton një raport të posaçëm me rekomandime për pozicionin negociues, i cili duhet të merret parasysh nga struktura negociatore.

5. Në rast se rekomandimet e Komisionit sipas pikës 4 të këtij neni nuk merren parasysh, ministri përgjegjës për negociatat informon me shkrim Komisionin mbi arsyet e mosmarrjes parasysh të rekomandimeve.

6. Struktura negociatore vijon me hartimin përfundimtar të pozicionit negociues nëse Komisioni për Çështjet Europiane nuk dërgon raportin e posaçëm me rekomandime brenda 14 ditëve nga data e paraqitjes pranë Komisionit.

7. Anëtarët e Komisionit për Çështjet Europiane hartojnë dhe nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit për marrjen në shqyrtim të pozicioneve negociuese.”.

Neni 11

Në nenin 16, pika 2 , fjala “përputhjen” zëvendësohet me “përafrimin” .

Neni 12

Në nenin 17, pika 1, fjala “përputhjen” zëvendësohet me fjalën “përafrimin”.

Neni 13

Pas nenit 17 shtohet neni 17/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 17/1

Procedura e shqyrtimit të ligjeve që synojnë përafrimin

Komisioni për Çështjet Europiane përfshin menjëherë në kalendarin e tij të punës dhe shqyrton me përparësi ligjet që synojnë përafrimin e legjislacionit, marrëveshjet që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe/apo detyrimeve që dalin nga procesi i negociatave të anëtarësimit.”.

Neni 14

Në nenin 18 pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për negociatat informojnë në seancë plenare konkluzionet mbi negocimin e një kapitulli ose grup kapitujsh pas zhvillimit të konferencës ndërqeveritare me Bashkimin European.”.

Neni 15

Në nenin 19 pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Ministri përgjegjës për integrimin european dhe ministri përgjegjës për negociatat paraqesin në fund të çdo 3-mujori në Komisionin për Çështjet Europiane një raport të hollësishëm mbi:

- a) listën e përditësuar të projektligjeve të lidhura me çështjet e integritit european, të cilat do t'i kalojnë për shqyrtim Kuvendit për periudhën vijuese;
- b) ecurinë e procesit të bisedimeve për anëtarësim;
- c) tekstet e plota të raporteve të paraqitura pranë strukturave të Komisionit European apo strukturave të përbashkëta, qëndrimet për çështjet e diskutuara, si dhe konkluzionet e rekomandimet e arritura nga këto takime;
- ç) axhendën e takimeve të përbashkëta të strukturave të Bashkimit European dhe Shqipërisë të ngritura sipas Marrëveshjes së Stabilizim –Asociimit, si dhe axhendën e takimeve të negociatave;
- d) raportin të paktën një muaj para zhvillimit të takimit të Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit mbi adresimin e rekomandimeve të marra prej tij nga institucionet përgjegjëse sipas fushës së përgjegjësisë.

Neni 16

Kudo në ligj togfjalëshi “Komisioni për Integrimin European” zëvendësohet me togfjalëshin “Komisioni për Çështjet Europiane”.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E

Lindita NIKOLLA

RELACION
PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN
NR.15/2015 “PËR ROLIN E KUVENDIT NË PROCESIN E INTEGRIMIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN”

I. QËLLIMI DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj ka për qëllim rritjen e rolit të Kuvendit në fazën në të cilën po kalon procesi i integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Projektligji i jep Kuvendit një rol të shtuar lidhur me metodologjinë e re të zgjerimit, e cila ka disa parime, si: dinamizmi, ku procesi do të jetë më i shpejtë sesa ka qenë, fakti se tani nuk do të kemi vetëm hapje dhe mbyllje kapitujsh por do të kemi grupe kapitujsh që e bën procesin shumë të shpejtë. Kjo kërkon që shteti kandidat që ka hapur negociatat, të reagojë më shpejt, duke i plotësuar më shpejt kushtet që vendosen dhe duke i miratuar më shpejt pozicionet negociatore.

Në këtë kuadër, projektligji i jep një rol të rëndësishëm Kuvendit, sidomos Komisionit për Çështjet Europiane, që të çojë përpara agjendën europiane, duke lehtësuar konsensusin për miratimin e ligjeve që do të jenë kritere për hapjen dhe mbylljen e negociatave, apo për hartimin e pozicioneve negociatore.

Projektligji ka si objekt përcaktimin e rregullave për marrëdhëniet e Kuvendit me Këshillin e Ministrave, ministrin përgjegjës për negociatat, institucionet e pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj në procesin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Projektligji jep garanci të shtuara edhe për rolin e Komisionit për Çështjet Europiane për procesin e përafrimit të legjislacionit, nga analiza e dispozitave në ligjin ekzistues “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”.

Projektligj ka si qëllim për t’iu përgjigjur kompleksitetit dhe seriozitetit të procesit të integritimit, i cili nuk është vetëm një proces politik por edhe ligjor.

Projektligji respekton parimet kryesore si atë të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, duke njohur përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave dhe strukturave negociatore, si ushtruese të pushtetit ekzekutiv për ndjekjen dhe administrimin e procesit të negociatave, nga ana tjetër gjithëpërfshirjen dhe rritjen e pjesëmarrjes së të gjitha grupeve parlamentare politike, por edhe të shoqërisë civile dhe të grupeve të interesit, sipas pozicioneve negociuese apo sipas kapitujve dhe, pa dyshim, rritjen e transparencës nga ana e Kuvendit në këtë proces.

Projektligji synon:

-T’i japë Kuvendit dhe Komisionit për Çështjet Europiane, një rol më aktiv dhe bashkëpunues në procesin e negociatave të Republikës të Shqipërisë me Bashkimin Europian duke përfshirë në kompetencat e Komisionit të Çështjeve Europiane edhe procedurën për shqyrtimin e pozicioneve negociuese.

- Dhënien e rekomandimeve për pozicionet negociuese.

-Shqyrtimin me përparësi të ligjeve që synojnë përafrimin e legjislacionit, marrëveshjet që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe/apo detyrimeve që dalin nga procesi i negociatave të anëtarësimit.

- Rritjen e rolit kontrollues të Kuvendit dhe të Komisionit për Çështjet Europiane për ecurinë e procesit për anëtarësim.

-Monitorimin e kriterëve të vendosura gjatë procesit të negociatave.

-Informimin mbi gjetjet kryesore të raportit të shqyrtimit analitik të legjislacionit të Komisionit Europian.

-Rritjen e kontrollit të Kuvendit për ecurinë e procesit të negociatave nëpërmjet raportimeve periodike çdo 3 muaj nga ministri përgjegjës për negociatat për ecurinë e procesit të negociatave në Komisionin për Çështjet Europiane.

II. BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian” është hartuar bazuar në nenet 77, 81, pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 24 të Rregullores të Kuvendit.

III. PËRMBATJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji përbëhet nga 17 nene.

Neni 1 riformulon objektin e ligjit nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian” duke përcaktuar rregulla për marrëdhëniet e Kuvendit me ministrin përgjegjës për negociatat dhe institucionet e pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj në çështjet e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Neni 2 zgjeron fushën e veprimit të ligjit nr. 15/2015, duke parashikuar rolin e Kuvendit në dhënien e rekomandimeve për pozicionet negociuese të Republikës së Shqipërisë në negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Europian; në monitorimin e kriterëve të vendosura gjatë procesit të negociatave, si dhe informimin mbi gjetjet kryesore të raportit të shqyrtimit analitik të legjislacionit të Komisionit Europian.

Neni 3 jep përkufizimin e pozicionit negociues dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Neni 4 riformulon përbërjen e Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian, e cila është gjithëpërfshirëse. Në Këshill marrim pjesë përfaqësues të grupeve parlamentare, kryetarët dhe nënkryetarët e komisioneve të përhershme të Kuvendit, përfaqësues nga kabineti i Kryeministrit; të Ministrisë së Jashtme, të Presidentit, ministri përgjegjës për integrimin dhe ministëri përgjegjës për negociatat me Bashkimin Europian, titullarët e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, që raportojnë dhe informojnë Kuvendin, përfaqësues nga organizatat e biznesit, nga Akademia e Shkencave dhe institucionet e arsimit të lartë publik, si dhe përfaqësues nga media, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe të trupit diplomatik.

Neni 5 parashikon kompetencat e Këshillit Kombëtar të Integrimit në lidhje me monitorimin e zbatimit të detyrimeve gjatë procesit të negociatave të anëtarësimit të Republikës Shqipërisë në Bashkimin Europian duke dhënë rekomandimet përkatëse për çështjet e shqyrtuara tek institucionet përgjegjëse; monitoron zbatimin e rekomandimeve të dhëna dhe informimin sipas rastit Komisionin për Çështjet Europiane për gjetjet e konstatuara gjatë monitorimit; nxitjen e bashkëpunimit midis forcave politike, institucioneve shtetërore dhe të pavarura dhe shoqërisë civile në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian; siguron diskutim të

vazhdueshëm për politikat e integritit europian, të zbatuara nga institucionet shtetërore me shoqërinë civile dhe me aktorë të tjerë të interesuar etj.

Neni 6 parashikon strukturën mbështetëse të Këshilli Kombëtar i Integritit Europian asistohet që do jetë Sekretariati Teknik, i cili kryen funksione këshillimore dhe administrative dhe përbëhet nga punonjësit e administratës së Kuvendit. Rregullat e detajuara për përbërjen, organizimin, funksionimin, numrin e punonjësve dhe përgjegjësitë e Sekretariatit Teknik miratohen me vendim të Byrosë së Kuvendit. Vendimi i Byrosë së Kuvendit për shtim të numrit të punonjësve në organikën e Kuvendit i dërgohet Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Financave për sigurimin e mbështetjes së nevojshme buxhetore për këtë qëllim”.

Neni 7 përcakton fushën e përgjegjësisë së Komisionit për Çështjet Europiane në çështjet e integritit europian; përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian; monitorimin e zbatimit të kriterëve gjatë procesit të negociatave, angazhimeve që rrjedhin nga kuadri negociator, Marrëveshja e Stabilizim - Asociimit, asistencës financiare të Bashkimit Europian për Shqipërinë, si dhe shqyrtimin dhe dhënien e rekomandimeve për pozicionet negociuese të Shqipërisë.

Neni 8 parashikon kompetencat e Kuvendit në çështjet europiane dhe angazhimet e Kuvendit në vendosjen e dialogut të përshtatshëm politik ndërmjet palëve në proces; monitorimin e zbatimit të kuadrit negociator, Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit dhe asistencën financiare të Bashkimit Europian, si dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal për çështjet e integritit europian.

Neni 9 parashikon rolin e Komisionit për Çështjet Europiane në shqyrtimin e pozicioneve negociuese dhe hartimin e raportit të posaçëm me rekomandime lidhur me këto pozicione negociuese jo të detyrueshme për strukturën negociuese; në lehtësimin e debatit politik dhe gjetjen e konsensusit ndërpartiak për miratimin dhe ndryshimin e ligjeve, strategjive apo rezolutave të nevojshme për përshpejtimin e procesit të negociatave. Parashikimi në këtë nen i raportime periodike çdo 3 muaj nga ministri përgjegjës për negociatat për ecurinë e procesit të negociatave forcon rolin e Komisionit në ushtrimin e funksionit kontrollues të Kuvendit nëpërmjet Komisionit për Çështjet Europiane. Ky nen parashikon edhe bashkërendimin e Komisionit për Çështjet Europiane me Komisionin për Politikën e Jashtme në organizimin e takimeve dhe diskutimeve me parlamentet kombëtare të shteteve anëtare dhe Parlamentin Europian, të drejtën për të thirrur dhe marrë mendim nga ekspertë të fushës dhe grupe interesi, mbikëqyrjen e zbatimit të kriterëve gjatë procesit të negociatave; të drejtën për të shqyrtuar të gjitha marrëveshjet që lidhen me institucionet e Bashkimit Europian dhe/ose me vendet e Bashkimit Europian, si dhe marrëveshjet me karakter të mbështetjes financiare.

Neni 10 parashikon procedurën e shqyrtimit të pozicioneve negociuese, afatet e shqyrtimit të tyre nga Komisioni për Çështjet Europiane, si dhe marrjen në shqyrtim nga struktura negociuese të raportit me rekomandime të Komisionit për pozicionet negociuese. Pika 6 e këtij neni parashikon edhe situatën zhblokuese nëse Komisioni nuk shqyrton në afat pozicionin negociues. Nisur nga natyra konfidenciale e pozicioneve negociuese, kjo dispozitë parashikon nënshkrimin e deklaratës së konfidencialitetit për marrjen në shqyrtim të pozicioneve negociuese.

Nenet 11 dhe 12 bëjnë rregullime të teknikës legislative.

Neni 13 parashikon procedurën e shqyrtimit të ligjeve që synojnë përafrimin e legjislacionit, marrëveshjet që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe/apo detyrimeve që dalin nga procesi i negociatave të anëtarësimit.

Neni 14 parashikon detyrimin e Këshillit të Ministrave dhe ministrit përgjegjës për negociatat që informojnë në seancë plenare Kuvendin për konkluzionet mbi negocimin e një kapitulli ose grup kapitujsh pas zhvillimit të konferencës ndërqeveritare me Bashkimin Europian.

Neni 15 parashikon çështjet për të cilat ministri përgjegjës për integrimin europian dhe ministri përgjegjës për negociatat paraqesin raport në fund të çdo 3-mujori në Komisionin për Çështjet Europiane.

Neni 16 bën rregullime të teknikës legislative.

Neni 17 parashikon hyrjen në fuqi të projektligjit pas botimit në Fletore Zyrtare.

Deputetët

Taulant Balla

Jorida Tabaku

Etilda Gjonaj

Mesila Doda

Fatmir Mediu

Toni Gogu

Kreshnik Collaku

Gerta Duraku